



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA POGRADEC
KËSHILLI

Nr. 5470/Prot.
7

Pogradec, më 06.12.2021

VENDIM

NR. 110, DATË 02.12.2021

PËR

**MIRATIMIN E STATUTIT TË SHOQËRISË "QËNDRA
MULTIFUNKSIONALE POGRADEC" SH.A.**

Në mbështetje të Ligjit Nr. 8417, datë 22.11.1998, "Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë", i ndryshuar, pikës 1 dhe pikës 2 të nenit 3 "Koncepti i autonomisë vendore" dhe nenit 4 "Rëndësia e autonomisë vendore" të Ligjit Nr.8548, datë 11.11.1999 "Për ratifikimin e "Kartës Europeiane të Autonomisë Vendore", Ligjit Nr.8480, date 27.5.1999, "Për funksionimin e organeve kolegjiale te administrates shteterore dhe enteve publike", pikës 4 të nenit 25, shkronjës "d" të pikës 1 të nenit 33, shkronjes "d" te nenit 54, shkronjes "f" te nenit 64 të Ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenet 6 -11, nenit 105, nenit 106, nenit 115, nenit 134, nenit 154, nenit 156, të Ligjit Nr.9901, datë 14.4.2008, "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, nenit 32 dhe nenit 36 të Ligjit Nr. 9723, datë 03.05.2007, "Per qendren kombetare te regjistrimit", i ndryshuar, bazuar në relacioni i paraqitur dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë,

KËSHILLI I BASHKISË

VENDOSI :

1. Të miratojë statutin e shoqërisë aksionare me një nivel, "**QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC**" Sh.a, sipas tekstit bashkëngjitur këtij vendimi dhe pjesë përbërse e tij.

2. Efektet: Sigurimi dhe mbrojtja e të drejtave të shtetasve, që merren me edukim fizik dhe sport si dhe krijimin e kushteve të nevojshme për zhvillimin sistematik nga të gjitha moshat të edukimit fizik.

Realizimi i të ardhurave në buxhetin e Bashkisë Pogradec, nga mirëadministrimi dhe dhenia me qera të ambjenteve që shoqeria do të ketë në administrim.

3. Për zbatim të këtij vendimi dhe regjistrimin e tij pranë Qëndrës Kombëtare të Biznesit, ngarkohen Kryetari i Bashkisë, Administrata e Bashkisë Pogradec dhe organet e shoqërisë.

4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë nga data e shpalljes.

5. U shpall sot më datë _____.2021.

K R Y E T A R

Sotiraq MANGĒRI



**STATUTI
I SHOQËRISË AKSIONARE**

"QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC" Sh. a.

Në këtë Statut:

- "Ligi" ose "Ligjt", është Ligji Nr. 9901, dt. 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar.
- "Statuti", është statuti i shoqërisë;
- "Asamble e përgjithshme", është Bashkia Pogradec, përfaqësuar nga kryetari i saj.
- "Aksionarë", janë personat emrat e të cilëve janë regjistruar në regjistrin e aksioneve të shoqërisë si zotërues të aksioneve;
- "Aksionari i vetëm", është bashkia Pogradec, me zotërim 100 % të aksioneve.
- "Ditë të Plota", në lidhje me periudhën e një njoftimi është periudha që nuk e përfshin ditën kur është dhënë ose kur konsiderohet se është dhënë njoftimi dhe ditën për të cilën është dhënë osc hyn në fuqi njoftimi.

KREU I

THEMELIMI, EMRI, OBJEKTI, KOHËZGJATJA, SELIA DHE ADRESA E FAQES SË INTERNETIT

NENI 1

DATA E THEMELIMIT, EMRI DHE THEMELUESIT

1.1 Më datë _____, bazuar në vullnetin e tyre dhe në përputhje me Ligjin nr. 9901, datë 14.04.2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", i ndryshuar, Bashkia Pogradec dhe Keshilli i Bashkise, vendosën të hartojnë këtë Statut për themelimin e shoqërisë aksionare "**QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC**" Sh.a, me një nivel, me oferte private, si vijon:

1.2 Aksionari i vetëm dhe themelues, i shoqërisë është Bashkia Pogradec, përfaqësuar ligjërish nga Z. ILIR XHAKOLLI, ne cilësinë e kryetarit të Bashkisë Pogradec, madhor me zotesi juridike për të vepruar i identifikuar me leternjoftimin me Nr. Personal G209252100.

**NENI 2
OBJEKTI**

2.1 Shoqëria do të kryejë aktivitetin e mëposhtëm:

- Projektimin, financimin, zhvillimin, menaxhimin e projekteve dhe veprimtarive sportive dhe kulturore, të të gjitha llojeve përjashtuar futbollin, me qellim nxitjen dhe masivizimin e sportit ndërthurur me kulturën, krijimin e akademive sportive dhe ekipeve zinxhir.
- Dhenien ne perdonim te treteve, ruajtjen, mirembajtjen, dhe menaxhimin e objekteve që shoqeria do të ketë në administrim.
- Çdo aktivitet tjeter ne perputhje me legjislacionin ne fuqi.
- Kryerja e pagesave te dietave, honorareve, sigurimeve dhe pagave.
- Kryerjen e të gjitha veprimeve te nevojshme për arritjen e qëllimit te shoqërisë.
- Përfaqësimin e shoqërive te ndryshme shqiptare apo te huaja që kane objekt te njëjtë apo te përafshërt me te kesaj shoqërie.



- Financimin e projekteve qe kane lidhje me veprimtarine e shoqërisë, të paraqitur nga shoqata të ndryshme ne territor të Republikes se Shqiperise.

**NENI 3
KOHËZGJATJA**

Kohëzgjatja e Shoqërisë do të jetë me afat të pacaktuar.

**NENI 4
SELIA, ADRESA E FAQES SË INTERNETIT DHE ADRESA ELEKTRONIKE**

4.1 Shoqëria e ka selinë e saj në Pogradec, pranë Qëndrës Kulturore "Lasgush Poradeci", me kod postar 7301.

4.2 Adresa e faqes së internetit të Shoqërisë do të jetë:
qendrasportivekulturorepogradeci.gov.al

4.3 Numri i kontaktit të shoqërisë është: +355 (83) 222222

**KREU II
KAPITALI I REGJISTRUAR**

**NENI 5
VLERA DHE PAGESAT E KAPITALIT TË REGJISTRUAR**

5.1 Kapitali themeltar i shoqërisë do te jete 3 500 000 (*Tre milion e peseqind mijë*) Lekë, i ndarë në 350 (Treqind e pesedhjete) aksione me vlerë nominale 10.000 (*Dhjete mijë*) lekë secili.

5.2 Aksionari i vetëm i shoqërisë dhe zotërues i 100 % të aksioneve është bashkia Pogradec.

5.3 Aksionari themelues i drejtohet gjykatës kompetente sipas vendndodhjes të selisë së Shoqërisë për të caktuar një ekspert të pavarur të licencuar për vlerësimin e kontributeve në natyrë. Raporti i ekspertit depozitohet në QKB -së, brenda afatit prej 6 muaj.

**NENI 6
KËRKESA PËR TË PAGUAR AKSIONET DHE TËRHEQJA E AKSIONEVE
TË PAPAGUARA**

6.1 Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund t'u kërkojë aksionarit pagimin e kontributeve te pashlyera në lidhje me aksionet e tyre dhe çdo aksionar (pas marrjes së njoftimit prej 14 Ditësh të Plota në të cilin përcaktohet koha dhe vendi i kryerjes së pagesës) i paguan shoqërisë shumën e kërkuar për aksionet e zotëruara. Njoftimi për pagesë mund të parashikojë shlyerjen me këste të kontributeve të papaguara. Personi të cilit i drejtohet njoftimi për pagesën e kontributit do të jetë përgjegjës për njoftimet që i drejtohen atij pavarësisht kalimit të mëpasshëm të pronësisë së aksioneve me të cilat lidhet njoftimi për pagesë.

6.2 Njoftimi për shlyerjen e kontributeve të aksionarëve do të konsiderohet i kryer në momentin e miratimit të vendimit të Këshillit të Administrimit për autorizimin e njoftimit.

6.3 Zotëruesit e përbashkët të një aksioni do të jenë përgjegjës bashkërisht dhe në mënyrë solidare për shlyerjen e kontributeve, sipas njoftimit të mësipërm.

6.4 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit te parashikuar, personi përgjegjës për shlyerjen e kontributeve do të paguajë një interes mbi shumën e papaguar me një kamatëvonesë prej 4% në vit duke filluar nga dita e parashikuar për pagesën.

6.5 Në rast se pas njoftimit për shlyerjen e kontributeve, pagesa përkatëse nuk kryhet brenda afatit të parashikuar, anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të njoftojnë paraprakisht të paktën tridhjetë Dità të Plota personin përgjegjës për shlyerjen e kontributeve, duke i kërkuar pagesën e shumës së pashlyer së bashku me shumat e mundshme shtesë të kamatëvonesës. Njoftimi do të përbajë vendin ku duhet të kryhet pagesa dhe deklarimin se në rast mosbatimi të tij, pasojat ligjore do të janë ato të parashikuara në pikën 2 dhe 3 të nenit 124 të Ligjit.

6.6 Nëse pagesa nuk kryhet brenda afatit te parashikuar në pikën 3 të nenit 124 të Ligjit, aksioni me të cilin lidhet njoftimi mund të anulohet me vendim të anëtarëve së Këshillit të Administrimit dhe anulimi do të përfshijë të gjithë dividendët ose shumat e tjera të pagueshme në lidhje me aksionet e anuluara dhe të papaguara deri në momentin e anulimit.

6.7 Anulimi i aksionit sjell zvogëlimin e kapitalit themeltar të Shoqërisë, në përputhje me parashikimin e nenit 186 të Ligjit.

6.8 Personi, aksionet e të cilil janë anuluar, humbet cilësinë e aksionarit lidhur me këto aksione por do të jetë përgjegjës ndaj Shoqërisë për të gjitha kontributet që do të shlyheshin nga ky aksionar ndaj shoqërisë në datën e anulimit të aksioneve së bashku me kamatëvonesën e llogaritur për këto kontribute përpara anulimit të aksioneve.

NENI 7

LLOJET E AKSIONEVE, OBLIGACIONEVE, TË DREJTAVE DHE KUFIZIMEVE

7.1 Ne përputhje me dispozitat e Ligjit dhe pa cënuar të drejtat që rrjedhin nga aksionet ekzistuese, aksionet e reja mund të emetohen me të drejtat ose kufizimet e parashikuara ne vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave të aksionarëve, sipas parashikimeve të nenit 145 të Ligjit.

7.2 Asambleja e Përgjithshme, me të njëjtën shumicë të kualifikuar votash, mund të vendosë emetimin e obligacioneve të cilat u garantojnë zotëruesve të tyre të drejtë për t'i kthyer në aksione ose të drejtën e parablerjes për aksionet (obligacionet e kthyeshme) dhe obligacionet që bëjnë të mundur pjesëmarrjen e zotëruesve të tyre në ndarjen e fitimeve në dobi të aksionarëve (obligacionet me pjesëmarrje në fitim).

NENI 8

CERTIFIKATAT E AKSIONEVE

Secili aksionar, që zotëron aksione, ka të drejtë të përfitojë një certifikatë për të gjitha aksionet e çdo klase të zotëruara nga ai, me pagesën e një shume që do të përcaktohet nga Asambleja e Përgjithshme. Shoqëria nuk është e detyruar të lëshoje më shumë se një certifikatë për aksionet e zotëruara bashkërisht nga disa persona dhe dorëzimi i certifikatës përfaqësuesit të zotëruesve të përbashkët të aksioneve do të konsiderohet si dorëzim i kryer ndaj të gjithë zotëruesve të aksioneve, në përputhje me pikën 1 të nenit 121 të Ligjit. Emrat e zotëruesve të përbashkët të aksioneve do të renditen në certifikatën e aksionit. Në këtë rast zbatohen dispozitat e pikës 2 të nenit 117 të Ligjit.

NENI 9

REGJISTRI I AKSIONEVE

Themeluesi është përgjegjës për krijimin e funksionimin e regjistrimit te aksioneve, në përputhje me nenin 119 të Ligjit, deri në momentin e emërimit nga Këshilli i Administrimit të Administratorit të ngarkuar me detyrën e mbajtjes së regjistrit të aksioneve.



NENI 10
KALIMI ME KONTRATË I AKSIONEVE

10.1 Kontrata e kalimit të aksionit bëhet me shkrim dhe sipas formalitetave të përcaktuara nga Administratori përgjegjës për mbajtjen e regjistrat të aksioneve të Shoqërisë dhe do të zbatohet nga dhe për llogari të personit që kalon aksionet ose nga personi i autorizuar prej tij dhe nga e për llogari të personit të cilit i kalohen aksionet ose nga personi i autorizuar prej tij, nëpërmjet regjistrimit në regjistrin e aksioneve të shoqërisë në përputhje me nenin 119 të Ligjit.

10.2 Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të refuzojnë regjistrimin e kalimit të aksionit në rast se ky aksion nuk është i shlyer ose nëse nuk janë dakord me personin në dobi të cilit kryhet kalimi i aksionit.

10.3 Nëse anëtarët e Këshillit të Administrimit refuzojnë të regjistrojnë kalimin e aksionit, do të njoftojnë për mospranimin personin të cilit i kalohen aksionet, brenda një muaji nga data në të cilën është paraqitur në shoqëri kërkesa për regjistrimin e kalimit të aksioneve.

NENI 11
KALIMI I AKSIONEVE ME TRASHËGIMI OSE FALIMENTIM

11.1 Nëse një aksionar vdes, trashëgimtarë ose trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të aksioneve, dhe përfaqësuesit e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm, do të jenë personat e vetëm të njohur nga Shoqëria së gjëzues i të drejtave mbi aksionin e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij statuti, pasuria e aksionarit të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me çdo aksion të bashkëzotëruar me persona të tjera.

11.2 Personi që fiton të drejtën mbi një aksion si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një aksionari, pas paraqitjes së provave të këruara nga anëtarët e Këshillit të Administrimit, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i aksionit ose të kërkojë regjistrimin e aksionit ne emër të një personi tjetër te caktuar prej tij si përfitues i aksionit. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i aksionit, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i aksionit, ai e kalon aksionin në dobi të personit tjetër.

11.3 Personi që fiton të drejta mbi një aksion si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një aksionari gjzon të drejtat që gjëzonte zotëruesi i aksionit, duke përashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme të Shoqërisë ose mbledhjeve të posaçme së aksionarëve të çdo klase aksionesh, deri në momentin e regjistrimit ne regjistrin e aksioneve të Shoqërisë si zotërues i aksionit.


NENI 12
ZMADHIMI DHE ZVOGËLIMI I KAPITALIT THEMELTAR

12.1 Zmadhimi i kapitalit të Shoqërisë mund të vendoset nga shumica e kualifikuar e votave të Asamblesë së Përgjithshme.

12.2 Kur emetohen aksione të reja, këto aksione iu ofrohen aksionarëve ekzistues përpresa se t'u ofrohen aksionarëve të tjera të rinj, në pajtim me nenin 174 të Ligjit. Aksionet e reja iu ofrohen aksionarëve sipas numrit të aksioneve që zotërojnë përpresa ofertës. Oferta që iu bëhet aksionarëve ekzistues duhet të pranohet brenda 20 ditësh.

12.3 Aksionet të cilat, në momentin e miratimit të vendimit të përmendur në pikën 1 të këtij nenit, nuk janë pranuar ose nuk është rënë dakord të pranohen nga asnjë aksionar, mund të anulohen dhe kapitali themeltar zvogëlohet në përputhje me vlerën e aksioneve të anuluara.

12.4 Në pajtim me Ligjin, Asambleja e Përgjithshme mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar të shoqërisë me shumicën e kualifikuar të votave të përcaktuara në fjalinë e dytë, pika 1 të këtij nenit.



**KREU III
ORGANET E SHOQERISE**

**NENI 13
ASAMBLEJA E PERGJITHSHME**

13.1 Asambleja e Përgjithshme merr vendime për çështjet e mëposhtëme të shoqërisë:

- a) përcaktimin e politikave tregtare;
- b) ndryshime të statutit;
- c) emërimin e shkarkimin e anëtarëve të këshillit të Administrimit (sistemi me një nivel);
- ç) emërimin e shkarkimin e likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
- d) miratimin e skemës së shpërblimeve për personat e përmendur në shkronjat "c" e "ç" të kësaj pike;
- dh) miratimin e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë;
- e) shpërndarjen e fitimeve vjetore;
- ë) zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar;
- f) pjesëtimin e aksioneve dhe anulimin e tyre;
- g) ndryshime në të drejtat, që lidhen me aksione të llojeve e kategorive të veçanta;
- gi) përfaqësimin e shoqërisë në gjykimet ndaj organeve të Administrimit;
- h) riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë;
- i) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të saj;
- j) çështje të tjera të parashikuara shprehimisht nga ligji apo statuti.

së ,Asambleja e Përgjithshme merr vendime pas shqyrtimit të dokumentave përkatëse 13.2 bashku me raportin e Këshillit të Administrimit dhe raportin e ekspertit kontabël të .autorizuar

Vendimet e Asamblesë së Përgjithshme që kanë lidhje me çështjet e përcaktuara në 13.3 .të merren me unanimitet (dhe k (gërmat h 1pikën

të drejtat dhe detyrimet e asamblesë së ,Mëqe shoqëria zotërohet nga një aksionar 13.4 perfaqesuar ligjërish ,bashkia Pogradec ,ga aksionari i vetëmpërgjithshme ushtrohen n .nga Kryetari i saj

Të gjitha vendimet e marra nga aksionari i vetëm regjistrohen në një regjistër të 13.5 uar Duhen regjistr .të dhënat e të cilit nuk mund të ndryshohen ose të fshihen ,vendimeve

:vendimet e mëposhtme ,por pa u kufizuar në to ,në veçanti ;miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë së veprimtarisë (a

;shpërndarja e fitimeve vjetore dhe mbulimi i hu mbjeve (b ;zmadhimi ose zvogëlimi i kapitalit (c

;endimet për investimev (ç ;riorganizimi dhe prishja e shoqërisë (d

**NENI 14
THIRRJA E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

14.1 Asambleja e Përgjithshme thirret nga Administratori të paktën dy herë në vit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit thërrasin Asamblenë e Përgjithshme në rastet e parashikuara në nenin 136 të Ligjit. Administratorët thërrisin menjëherë Asamblenë e Përgjithshme në rast se kërkohet nga aksionarët e përcaktuar sipas pikës 1 të nenit 139 të Ligjit.

14.2 Mbledha e Asamblesë së Përgjithshme thirret nëpërmjet një njoftimi të dërguar me postë ose postë elektronike (*email*) drejtuar çdo aksionari, përfshirë edhe përfaqësuesin e aksioneve në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën njëzet e një Ditë të Plota përparrat datës së caktuar për mbledhjen. Secilit aksionar, së bashku me njoftimin për mbledhjen, i dërgohet edhe numrat PIN për të mundësuar pjesëmarrjen dhe votimin elektronik në mbledhje.



14.3 Mbledhjet e Asamblesë se Përgjithshme janë të pavlefshme në rast moskryerje të paqëllimshme së njoftimit apo mos-marrjes së njoftimit të mbledhjes nga personat të cilët kanë të drejtë të marrin këtë njoftim, me përjashtim të rastit kur shoqëria provon se personi i ka dhënë shoqërisë një adresë të pasaktë.

**NENI 15
MBLEDHJET E ASAMBLESË SË PËRGJITHSHME**

15.1. Asambleja e përgjithshme mblidhet në rastet e përcaktuara nga ligji, nga ligje të tjera ose nga dispozitat e statutit dhe sa herë që mbledhja është e nevojshme për të mbrojtur interesat e shoqërisë. Mbledhja e zakonshme e asamblesë së përgjithshme thirret të paktën një herë në vit.

15.2. Asambleja e përgjithshme thirret nga administratori dhe, në rastet e parashikuara nga ky ligj, nga anëtarët e Këshillit të Administrimit.

15.3. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret nëse, sipas bilancit vjetor apo raporteve të ndërmjetme financiare, rezulton apo parashikohet qartë se humbjet arrijnë në një vlerë të barabartë me 50 për qind të kapitalit të regjistruar ose që aktivet e shoqërisë nuk mbulojnë detyrimet, që janë të kërkueshme brenda 3 muajve në vijim.

15.4. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria propozon të shesë apo të disponojë aktive, të cilat kanë një vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

15.5. Asambleja e përgjithshme duhet të thirret, kur shoqëria, brenda 2 viteve të para pas regjistrimit, propozon të blejë, nga një aksionar, pasuri që kanë vlerë më të lartë se 5 për qind të aseteve të shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare të certifikuara.

**NENI 16
VOTIMI ME PROKURË**

16.1 Përfaqësuesi do të emërohet nga një pjesëmarrës në mbledhje sipas formës së mëposhtme (ose në formën e zakonshme apo formën që mund te miratohet nga anëtarët e Këshillit të Administrimit): " _____ " Sh.a.

Unë/Ne i/të nënshkruari/t,, në cilësinë e aksionarit/aksionarëve të shoqërisë së lartpërmendor, emëroj/më), ose në pamundësi të tij,, në cilësinë e përfaqësuesit/ve tim/tonë për të votuar në emër/emrat tim/tonë dhe në llogarinë time/tonë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme të shoqërisë e cila do të mbahet më 20....., dhe në çdo mbledhje të shtyrë.

Nënshkruar më..... 20.....".

16.2 Caktimi me shkrim i përfaqësuesit ose një kopje e noterizuar apo e miratuar nga Administratori depozitohet në zyrën qendrore të shoqërisë ose në një vend tjeter brenda territorit të Republikës së Shqipërisë, siç përcaktohet në njoftimin për mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme ose në ftesën për të caktuar një përfaqësues të dërguar nga shoqëria në lidhje me mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme. Akti i emërimit të përfaqësuesit duhet të depozitohet jo më vonë se 48 orë përpëra orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë, në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

16.3 Në rast se akti i emërimit të përfaqësuesit jepet nëpërmjet komunikimit elektronik të dërguar në adresën elektronike (*email*) sipas përcaktimeve të pikës 3 të nenit 4, të këtij Statuti, ky akt duhet të merret jo më vonë se 48 orë përpëra orës së mbledhjes ose mbledhjes së shtyrë në të cilën duhet të votojë përfaqësuesi.

EMËRIMI I EKSPERTËVE KONTABËL TË AUTORIZUAR

17.1 Me propozim të Këshillit të Administrimit, Asambleja e Përgjithshme cakton një ose më shumë persona fizikë ose një shoqëri ekspertësh kontabël të autorizuar si ekspertë kontabël të autorizuar të shoqërisë për tre vjet me radhë, në pajtim me shkronjën "ç", pika 2, nen 135 të Ligjit. Emërimi bëhet nëpërmjet një vendimi të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të zakonshme, i cili nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si ekspert kontabël të autorizuar të Shoqërisë.

17.2 Gjatë mandatit të tyre, ekspertët kontabël të autorizuar mund të largohen nga detyra vetëm për shkaqe të arsyeshme. Mendimet e ndryshme për metodat e kontabilitetit apo procedurat e kontrollit nuk përbëjnë shkaqe të arsyeshme për largimin ekspertëve kontabël të autorizuar.

17.3 Eksperti Kontabël i Autorizuar ose shoqëria e Ekspertëve Kontabël të Autorizuar i raporton komitetit të kontrollit të Këshillit të Administrimit, për çështjet kryesore që rezultojnë nga kontrolli financiar dhe, në veçanti, për dobësi të kontrollit të brendshëm në lidhje me procesin e raportimit financiar.

17.4 Ekspert Kontabël i Autorizuar, të emërohet nga Asambleja e Përgjithshme e Shoqërisë, sipas formatit si me poshtë:

- Subjekti ose shoqëria _____, me Licencë IEKA leshuar sipas vendimit te Komitetit te Regjistrimit nr. _____, date _____, , me adresë në,
“_____”.

KREU IV KËSHILLI I ADMINISTRIMIT DHE ADMINISTRATORI

NENI 18

EMËRIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT

18.1 Asambleja e Përgjithshme cakton tre persona fizikë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, në pajtim me shkronjën "c", pika 2 të nenit 135 dhe pikën 2 të nenit 155 të Ligjit. Emërimet do të janë individuale dhe në përputhje me vendimin e mbledhjes së Asamblesë së Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si anëtar të Këshillit të Administrimit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të shkarkohen nga detyra nga Asambleja e Përgjithshme, pa cenuar të drejtat qe burojnë nga një kontratë pune e lidhur me Shoqërinë.

(2) Shumica e anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të janë të pavarur dhe nuk do të janë Administratorë, në përputhje me parashikimet e pikës 1 dhe 4 të nenit 155 të Ligjit.

(3) Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të caktojnë një person i cili dëshiron të veprojë në cilësinë e kryetarit të Këshillit të Administrimit, duke pasur parasysh se emërimi nuk përbën zmadhim të numrit të anëtarëve, të përmendur në pikën 1 të këtij nenit.

(4) Anëtarët e Këshillit të Administrimit të Shoqërisë, do të emërohen nga Asambleja e Përgjithshme, për të qëndruar në detyrë për një afat 3 (tre) vjeçar, sipas formatit si më poshtë:

në _____ Znj/Z .1, shtetas/e shqiptar, i datëlindjes _____, lindur
në _____, banues me adresë në "_____".
kodi postar _____, mbajtës i Letërmjofimit ID nr.

_____ dhe nr. Personal _____, në detyrën
"_____", " në shoqërinë QËNDRA MULTIFUNKSIONALE
POGRADEC" sh.a.



Znj/Z .2, shtetas/e shqiptar, i datëlindjes _____, lindur
në _____, banues me adresë në " _____",
kodi postar _____, mbajtës i Letërnjoftimit ID nr.
dhe nr. Personal _____, në detyrën
" _____", " në shoqerinë **QËNDRA MULTIFUNKSIONALE**
POGRADEC" sh.a.

Znj/Z .3, shtetas/e shqiptar, i datëlindjes _____, lindur
në _____, banues me adresë në
" _____", kod i postar _____, mbajtës i
Letërnjoftimit ID nr. _____ dhe nr. Personal
_____, në detyrën " _____", në shoqerinë
QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC" sh.a.

NENI 19
EMËRIMI I ADMINISTRATORIT:

19.1 Këshilli i Administrimit do te zgjedhe një person fizik si Administrator dhe përfaqësues të Shoqërisë për një periudhë 3 (tre vjeçare), në pajtim me nenin 158 të Ligjit. Emërimi do të jenë individual dhe sipas një vendimi të Këshillit të Administrimit, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.

Administratori mund të shkarkohet por, pa cënuar të drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.

19.2 Administrator i Shoqërisë, i cili do të qëndrojë në detyrë për një periudhë 3 (tre) vjeçare si më poshtë:

Z/Znj _____, shtetas/e shqiptar, i/e datëlindjes
_____, lindur në _____, banues ne adresa
" _____", kod i postar _____, mbajtës i ID-së NR. _____ dhe në detyrën "**ADMINISTRATOR**", i
"shoqërisë **QËNDRA MULTIFUNKSIONALE POGRADEC**" sh.a.

NENI 20
**KOMPETENCAT E KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT DHE KOMITETEVE TË
TIJ**

20.1 Këshilli i Administrimit përbëhet nga tre persona fizikë si anëtarë të tij. Emëritimet do të jenë individuale. Anëtarët e Këshillit te Administrimit emërtohen dhe shkarkohen nga detyra në çdo kohë nga Kryetari i Bashkisë.

20.2 Shpërblimi mujar për Këshillin Mbikqyrës të jetë sipas akteve ligjore në fuqi.

20.3 Mandati i Anëtarëve të Këshillit Mbikqyrës është 3 (tre) vjeçar.

20.4 Anëtarët e Këshillit te Administrimit janë të pavarur dhe nuk do të jenë Administratorë.

20.5 Këshilli i Administrimit ka këto të drejta dhe përgjegjësi:

- a) të japë direktiva për administratorët për zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë;
- b) të kontrollojë e të mbikëqyrë zbatimin e politikave tregtare të shoqërisë nga administratorët;



- c) tē përgatisë, me kërkesë tē asamblesë së përgjithshme, marrjen e masave, që janë në kompetencë tē kësaj tē fundit, t'i rekomandojë asaj vendime tē nevojshme pér t'u marrë, si dhe tē zbatojë vendimet e asamblesë;
 - ç) tē thërrasë mbledhjen e asamblesë së përgjithshme, sa herë vlerësohet e nevojshme pér interesat e shoqërisë;
 - d) tē kujdeset që shoqëria tē respektojë ligjin dhe standartet e kontabilitetit;
 - dh) tē shqyrtojë e tē kontrollojë librat kontabël, dokumentet dhe aktivet e shoqërisë;
 - e) tē sigurojë se pasqyrat financiare vjetore, raportet e ecurisë së veprimtarisë, si dhe detyrimet e tjera tē raportimit e publikimit, tē detyrueshme në bazë tē ligjit apo statutit, tē kryhen me saktësi nga administratorët. Këto dokumente duhet tē miratohen e tē nënshkruhen nga tē gjithë e anëtarët e këshillit tē administrimit pér t'u paraqitur asamblesë së përgjithshme, së bashku me një raport tē këshillit tē administrimit pér miratim dhe një përshkrim pér mbikëqyrjen e menaxhimit gjatë tē gjithë viti finanziar;
 - ë) tē sigurojë se auditimi i librave dhe i regjistrimeve kontabël tē kryhet tē paktën një herë në vit nga një ekspert kontabël i autorizuar, i pavarur e rapporti i auditimit, drejtuar asamblesë së përgjithshme, t'u vihet në dispozicion tē gjithë anëtarëve tē këshillit e administratorëve. Raporti i këshillit tē administrimit, përmendur në shkronjën "e" tē kësaj pike, duhet tē përbajë edhe mendimin pér reportin e auditimit;
 - f) tē emërojë dhe tē shkarkojë administratorin;
 - g) tē përcaktojë shpërblimin e administratorit;
 - gj) tē miratojë marrjen përsipër tē detyrimeve me vlerë më të lartë se 5 pér qind tē aseteve tē shoqërisë, që rezulton në pasqyrat e fundit financiare, tē certifikuara, nëpërmjet nënshkrimit tē huave apo emetimit tē obligacioneve apo instrumenteve tē tjera tē borxhit;
 - k) tē vendosë krijimin e bashkëpunimeve tregtare afatgjata dhe propozimin e politikave, pér themelimin e shoqërive tregtare ose tē grupeve tē reja;
 - i) tē kryejë veprimet e tjera, tē përcaktuara në ligj dhe në statut.
- 20.6. Në rastet e parashikuara në pikat 3, 4 e 5 tē nenit 136 tē këtij ligji 9901, këshilli i administrimit duhet tē thërrasë menjëherë asamblenë e përgjithshme, pér tē shqyrtuar nëse shoqëria duhet tē prishet ose pér marrjen e masave tē tjera tē nevojshme e tē përshtatshme.

NENI 21 KOMPETENCAT E ADMINISTRATORIT

21.1 Administratori emërohet në detyrë nga Këshilli i Administrimit, pér një periudhë 3 (Tre) vjeçar. Emëritimet do tē janë individuale.

Administratorët mund tē shkarkohen në çdo kohë nga detyra, pa cënuar tē drejtat që burojnë nga një kontratë pune e lidhur me shoqërinë.

21.2 Politikat tregtare tē shoqërisë do tē administrohen dhe shoqëria do tē përfaqësohet nga Administratori i cili mund tē ushtrojnë tē gjitha kompetencat e tyre në përputhje me parashikimet e statutit.

21.3 Administratori ka këto tē drejta dhe detyrime:

- tē kryejë tē gjitha veprimet e administrimit tē veprimtarisë tregtare tē shoqërisë;
- tē përfaqësojë shoqërinë tregtarë;
- tē kujdeset pér mbajtjen e saktë e tē rregullt tē dokumentave dhe tē librave kontabël tē shoqërisë;
- tē përgatisi dhe tē nënshkruajë bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe reportin e ecurisë së veprimtarisë, tē cilët ia paraqesin këshillit te administrimit pér miratim, së bashku me propozimet pér shpërndarjen e fitimeve, pér t'u paraqitur më pas pér miratim nga asambleja e përgjithshme;
- tē krijojë një sistem monitorimi e njostimi tē hershëm pér rrethanat, që kërcënojnë ekzistencën e shoqërisë;

- f. tē kryejë regjistrimet e publikimet e detyrueshme të tē dhënavë të shoqërisë, sipas parashikimeve të këtij ligji apo tē ligjeve të tjera;
- g. tē raportojnë përpara këshillit të Administrimit pér zbatimin e politikave tregtare dhe me realizimin e veprimtarive me rëndësi të veçantë, pér veprimtarinë e shoqërisë;

NENI 22

SKUALIFIKIMI DHE SHKARKIMI I ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT

22.1 Detyra e anëtarit të Këshillit të Administrimit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më anëtar i Këshillit të Administrimit në bazë të dispozitave të Ligjit përfshirë nenin 157 dhe pikën 7 të nenit 158.
2. personi ndodhet në gjendje paftësie paguese;
3. personi vuau ose mund të vuajë nga çrrëgullime mendore;
4. personi jep dorëheqjen nga detyra duke njofuar shoqërinë, ose
5. ka munguar pér më shumë se gjashtë muaj radhazi pa lejen e anëtarëve të tjerë të Këshillit të Administrimit në mbledhjet e këtij këshilli të mbajtura gjatë kësaj periudhe dhe Këshilli i Administrimit vendos ta shkarkojë nga detyra.

NENI 23

HETIMET E POSAÇME DHE MBIKËQYRJA

Çdo person ose personat që plotësojnë kushtet pér tē kërkuar emërimin ose zëvendësimin e një eksperti të posaçëm në bazë të nenit 150 të Ligjit ose pér tē kërkuar nga Këshilli i Administrimit që tē kryejë detyrat e mbikëqyrjes në rastet e veçanta të parashikuara nga nenit 165 i Ligjit, depozitojnë në selinë e shoqërisë dokumentin e noterizuar i cili vërteton se ky/këta person/a plotësojnë kushtet pér tē kryer këtë veprim.

NENI 24

SHPËRBLIMI DHE KOSTOT E ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT

(1) Anëtarët e Këshillit të Administrimit dhe Administratori do tē kenë tē drejtë tē shpërblehen në bazë të skemës së vendosur nga Këshilli i Administrimit dhe të miratuar me vendim të Asamblesë së Përgjithshme, në përputhje me pikën 1, nenit 160 të Ligjit.

(2) Me miratimin e Asamblesë së Përgjithshme, Këshilli i Administrimit mund tē shpërndajë shpërblime në para, pensione, sigurime ose forma të tjera, pér ata anëtarë të Këshillit të Administrimit të cilët kanë pasur detyra dhe kanë punuar më parë pér shoqërinë ose kanë pasur detyra në organe të saj, shoqëri të tjera të cilat janë ose kanë qenë shoqëri të kontrolluara ose pér shoqëri paraardhëse të shoqërisë ekzistuese ose tē filialeve të saj, ose pér çdo familjar të tyre (përfshirë bashkëshortin/en, ish-bashkëshortin/en) ose persona të cilët janë ose ishin në varësi të tyre, dhe Këshilli i Administrimit mund tē paguajë kontributë në fonde të caktuara pér dhëni e përfitimeve të tillë.

(4) Anëtarëve të Këshillit të Administrimit mund t'i u paguhen tē gjitha shpenzimet e udhëtimit, hotelit dhe shpenzime të tjera pér pjesëmarjen e tyre në mbledhjet e Këshillit të Administrimit ose komitetet e krijuara nga Këshilli i Administrimit ose mbledhjet e Asambleve të Përgjithshme ose takimet e posaçme të zotëruarve të aksioneve të klasave të ndryshme ose tē obligacioneve të Shoqërisë ose në lidhje me përbushjen e detyrave të tyre.

NENI 25
MBLEDHJET E KËSHILLIT TË ADMINISTRIMIT

1. Mbledhjet e Këshillit të Administrimit do të mbahen të paktën dy herë në vit sipas nevojave të aktivitetit tregtar të Shoqërisë, derisa Asambleja e Përgjithshme të vendosë me shumicë të zakonshme votash mbi shpeshtësinë e mbledhjeve të Këshillit të Administrimit.
- (2) Vendimet e Këshillit të Administrimit merren me kuorumin e përcaktuar në nenin 162 të Ligjit. Anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të marrin pjesë në mbledhje nëpërmjet mjeteve elektronike të komunikimit përfshirë komunikimin video dhe audio konferencë. Ata mund të marrin pjesë në votime duke përdorur numrin PIN të lëshuar çdo anëtarë në momentin e emërimit.
- (3) Anëtarët e Këshillit të Administrimit emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes, i cili mund të shkarkohet në çdo kohë nga kjo detyrë. Administratori nuk mund të emërohet si Kryetar i Këshillit të Administrimit. Kryetari do të drejtojë çdo takim të Këshillit të Administrimit në të cilin ai është i pranishëm. Në rast se Kryetari nuk dëshiron të drejtojë mbledhjen apo nuk është i pranishëm brenda pesë minutave nga orari i caktuar për mbledhjen, anëtarët e Këshillit të Administrimit mund të emërojnë njërin prej tyre si Kryetar të mbledhjes.
- (4) Çështjet e rendit të ditës vendosen me shumicën e votave të pjesëmarrësve. Në rast numri të barabartë votash, vota e Kryetarit do të jetë vendimtare.
- (5) Të gjitha aktet e kryera nga mbledhja e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ose komitetet e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, ose nga persona të cilët veprojnë si anëtarë të Këshillit të Administrimit, pavarësisht nëse bëhet e ditur më pas se emërimi i anëtarit të Këshillit të Administrimit ka pasur mangësi ose këta anëtarë janë skualifikuar nga mbajtja e kësaj detyre, ose nuk kishin të drejtë të votonin, do të konsiderohen të vlefshme njëlloj sikur këta persona të ishin emëruar rregullisht dhe të ishin cilësuar e të vazhdonin detyrën si anëtarë të Këshillit të Administrimit dhe të kishin të drejtë të votonin në mbledhje.
- (6) Vendimi me shkrim i nënshkruar nga të gjithë anëtarët e Këshillit të Administrimit që kanë të drejtë të njostohen për mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose të komitetit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit do të konsiderohet si i vlefshëm dhe i efektshëm njëlloj si të ishte miratuar në mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose në komitetin e anëtarëve të Këshillit të Administrimit, të thirrur dhe mbledhur rregullisht.

NENI 26
KUFIZIMET NË VOTIME

- (1) Anëtarët e Këshillit të Administrimit nuk do të lidhin marrëveshje ose votojnë në mbledhjen e Këshillit të Administrimit ose të komitetit të anëtarëve të Këshillit të Administrimit mbi çështje në të cilin këta anëtarë kanë, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është ose mund të jetë në kundërshtim me interesat e Shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit, deri në momentin kur në mbledhjen e Këshillit të Administrimit, të gjithë anëtarët kanë rënë dakord që:
 1. të autorizojnë lidhjen e kësaj marrëveshje; dhe
 2. të autorizojnë këtë anëtar që të votojë në lidhje me këtë çështje.Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çështje të caktuar. Zbatohet parashikimi i pikës 2 dhe 5 të nenit 13 të Ligjit.
- (2) Vota e anëtarit të Këshillit së Administrimit nuk do të llogaritet në kuorumin e pjesëmarrësve në mbledhje në lidhje me vendimin për të cilin ky anëtar nuk ka të drejtë të votojë.



(3) Në rast se në mbledhjen e Këshillit të Administrimit diskutohet një çështje e lidhur me të drejtën e votës së një anëtarë të tij, çështja, përpëra përfundimit të mbledhjes, mund ti drejtohet Kryetarit të mbledhjes dhe vendimi i tij lidhur me çdo anëtar të Këshillit të Administrimit të ndryshëm nga ai vetë do të jetë përfundimtar.

NENI 27
**PROCESVERBALI I MBLEDHJES SË ANËTARËVE TË KËSHILLIT TË
ADMINISTRIMIT**

Anëtarët e Këshillit të Administrimit do të mundësojnë mbajtjen e procesverbaleve të mbledhjeve në libra të posaçëm për:

1. Të gjithë emërimet e kryera nga anëtarët e Këshillit të Administrimit; dhe
2. Të gjithë mbledhjet e Asamblesë së Përgjithshme, mbledhjet e zotëruesve së aksioneve të klasave të ndryshme, dhe mbledhjet e Këshillit të Administrimit dhe komiteteve të Këshillit të Administrimit, përfshirë edhe emrat e anëtarëve të Këshillit të Administrimit të pranishëm në këto mbledhje.

KREU V
**DIVIDENDËT DHE KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN
THEMELTAR**

NENI 28
DIVIDENDËT

(1) Në përputhje me dispozitat e Ligjit, shoqëria me shumicë të zakonshme të votave së Asamblesë së Përgjithshme mund të deklarojë dividendët në përputhje me të drejtat përkatëse të aksionarëve.

(2) Me përashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe nga të drejtat që lidhen me aksionet, të gjithë dividendët deklarohen dhe paguhen në përputhje me shumat e paguara për aksionet për të cilët paguhet dividendi. Të gjithë dividendët pjesëtohen dhe paguhen në përpjesëtim të drejtë me shumat e paguara për aksionet, pjesës ose pjesëve të periudhës për të cilën paguhet dividendi; në rast se aksioni emetohet me kushtin e përshtimit të dividendift nga një datë e caktuar, dividendi do të paguhet në përputhje me këtë kusht.

(3) Asnjë dividend ose pagesë në para që lidhet me një aksion nuk prodhon interesa kundrejt shoqërisë nëse një gjë e tillë nuk parashikohet në të drejtat e aksionit.

(4) Çdo dividend që nuk është kërkuar të paguhet brenda dymbëdhjetë vjetëve nga data e maturimit, në rast se vendoset nga Këshilli i Administrimit, do të përfitohet nga shoqëria e cila nuk do të jetë më e detyruar që ta paguajë atë.

NENI 29
KALIMI I FITIMEVE NË KAPITALIN THEMELTAR

Këshilli i Administrimit, pas vendimit të marrë nga Asambleja e Përgjithshme me shumicë votash sipas kuorumi të përcaktuar nga neni 145 i Ligjit, mund të vendosë të kalojë në kapitalin themeltar të Shoqërisë fitimet e pashpërndara të cilat nuk do të përdoren për të paguar dividendë preferencialë apo shuma të tjera të parashikuara për rezerva ligjore ose kapitali.



**KREU VI
PRISHJA DHE NJOFTIMET**

**NENI 30
PRISHJA DHE LIKUIDIMI**

Në rast të likuidimit të Shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e posaçem të Asamblesë së Përgjithshme të marrë me shumicë të kualifikuar, mund të shpërndajë në dobi të aksionarëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të Shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis aksionarëve ose atyre që zotërojnë aksione të klasave të ndryshme të Shoqërisë.

**NENI 31
NJOFTIMET**

(1) Çdo njoftim që u jepet ose kryhet nga persona sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jetë me shkrim ose përmes komunikimit elektronik në adresën e parashikuar në pikën 3 të nenit 4 të këtij Statuti është i vlefshëm në kohën e njoftuar për këtë qëllim personit i cili kryen njoftimin.

(2) Shoqëria mund t'i japë njoftim një aksionari, personalisht ose duke e dërguar me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të aksionarit ose ne adresën apo posten elektronike e cila i është njoftuar Shoqërisë nga aksionari. Kur ka disa bashkëzotërues të një aksioni, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në pajtim me pikën 1 të nenit 121 të Ligjit.

**NENI 32
DISPOZITA PËRFUNDIMTARE**

Ky Statut përpilohet në 5 (*Pese*) ekzemplarë origjinalë, me 13 fletë secila, me vlerë të njëjtë ligjore, në gjuhën shqipe, njëri prej të cilëve do të depozitohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit, Statuti mbylljet me 32 (*tridhjetë e dy*) nene.

Ky Statut do të hyjë në fuqi menjëherë me regjistrimin e tij në QKB.

Lexuar, miratuar dhe nënshkruar,



NËNSHKRIMI I AKSIONARIT THEMELUES:

BASHKIA POGRADEC

(Në cilësinë e Asamblesë së Përgjithshme)

(Ligjërisht e përfaqësuar nga)

**KRYETARI I BASHKISË
ILIR XHAKOLLI**